

PYETJET E HISTORISË SË ARTIT

Departamenti i Skulpturës

Pyetjet janë të ndara në numra rendor dhe çdo numër përmban tre nënpyetje:

- a** - Nga historia e artit botëror
- b** – Nga historia e artit shqiptar
- c** - Nga specialiteti i zgjedhur

Pyetjet shërbejnë për njërën nga fazat e konkursit të pranimit të studentëve në Universitetin e Arteve, Fakulteti i Arteve të Bukura. Krahas konkurimit praktik në pikturë, skulpturë dhe vizatim, studenti testohet edhe teorikisht për njohuritë e tij rreth Historisë së Artit botëror, Historisë së Artit Shqiptar me specifikisht mbi specialitetin e përzgjedhur.

Pyetjet shërbejnë si një orientim fillestar në bashkëbisedim. Anëtarët e komisionit kanë të drejtë të bëjnë dhe pyetje shtesë kur ata e shohin të nevojshme.

Secili student tërheq tezën me pyetjet dhe përgjigjet në prani të komisionit. Studenti ka të drejtë të tërheqë pyetjet deri në dy herë.

...

PYETJET PËR ATELIERIN TË SKULPTURË

Teza nr 1.

a) Historia e Artit ndahet në periudha. Përmendni si ndryshoi ai nga Antikiteti në Mesjetë dhe më pas në Rilindje.

b) Cili është autori i monumentit të Skënderbeut që është vendosur në sheshin qendror të Krujës? Në cilin qytet është vendosur kopja e kësaj vepre vitet e fundit?

c) Vazot e qeramikës datojnë që nga fillimet e njerëzimit. Flisni për teknologjinë e ndërtimit të tyre.

Teza nr 2.

a) Flisni për surrelizmin dhe piktorin Salvador Dali. Flisni për karakteristikat e veprës së këtij artisti.

b) Cilët janë autorët e monumentit “Skënderbeu mbi kalë” që ndodhet në sheshin e Tiranës? Në ç’periudhë u realizua ajo?

c) Si realizohet një vepër në bronz. Shpjegoni në cilat etapa kalon realizmi i saj.

Teza nr. 3.

a) Përmend disa nga dëshmitë artistike më të rëndësishme të artit klasik Grek, në skulpture. Pse u quajt “Klasike” dhe në cilën periudhë tjetër të artit pati influencë të dukëshme?

b) Cito disa piktorë të artit bizantin në Shqipëri. Në muzeun e cilit qytet ruhet koleksioni më i madh i ikonave në Shqipëri?

c) Cili është autori i monumentit të parë në Shqipëri dhe cila është vepra që ai krijoi?

Teza nr. 4.

a) Cila është tema qendrore në pikturat e vazove të periudhës së artit Grek? Cito tre emra skulptorësh të shquar në artin Klasik Grek.

b) Cili është autori i monumentit “Ushtari I Panjohur” që ndodhet në Tiranë.

c) Cito tre vepra të skulptorit Odhise Paskali. Përshkruajini ato dhe flisni për kushtet historike në të cilat ato u realizuan.

Teza nr. 5.

a) Cito emrat e pesë skulptorëve italian. Fol më zgjeruar për njërin prej tyre.

b) Kush ishte Onufri dhe cilat janë karakteristikat e veprës së tij? Në cilët muze ruhen ato sot?

c) Citoni emrat e pesë skulptorëve të Realizmit socialist në Shqipëri. Fol më zgjeruar për njërin prej tyre dhe karakteristikat kryesore të krijimtarisë së tyre.

Teza nr. 6.

a) Ç’përfaqson Futurizmi? Kush ishin përfaqësuesit e tij? Cito një vepër futuriste në skulpturë apo në pikturë.

b) Cito emrat e dy skulptorëve qeramistë në Shqipëri. Flisni më gjatë për teknologjinë e qeramikës në vendin tonë.

c) Cilët janë autorët e Monumentit të Pavarsisë në Vlorë. Shpjegoni kontekstin e kohës kur u ngrit kjo vepër dhe përshkruani atë.

Teza nr. 7.

a) Ç'përfaqson Kubizmi? Cito emrat e dy piktorëve kubistë. Cila është vepra e parë që zyrtarisht u etiketua kubiste?

b) Cilët janë autorët e grupit skulpturor "4 Heroinat e Mirditës". Flisni për këtë vepër dhe ku gjendet ajo sot?

c) Flisni për një skulptor bashkohor shqiptar. Shpjegoni me fjalët tuaja veprën e tij. Citoni një ekspozitë personale të tij dhe flisni rreth saj.

Teza nr. 8.

a) Ç'përfaqson Ekspresionizmi abstrakt? Kush janë përfaqësuesit më të spikatur të tij? Përmend titullin e një vepre të kësaj rryme.

b) Ku ndodhet sot skulptura "Dea e Butrintit"? Bëni një shpjegim të saj dhe periudhës artistike kur ajo është realizuar.

c) Citoni një skulpturë në mermer që keni parë. Shpjegoni teknikën që duhet për të realizuar një skulpturë të tillë.

Teza nr. 9.

a) Cito disa skulptorë të Rilindjes italiane. Cilat ishin karakteristikat kryesore të artit në këtë periudhë dhe në ç'kushte historike u zhvilluan ato?

b) Citoni një vepër të skulptorit Shaban Hadëri dhe përshkruajeni atë.

c) Cito një ekspozitë të arteve vizive që ke vizituar në Shqipëri dhe komento më gjërë rreth saj.

Teza nr. 10.

a) Çfarë karakteristikash kishte arti në Egjiptin e lashtë? A ekzistonte një kanon artistik? Jep një shembull konkret dhe komento rreth tij.

b) Cito një vepër të skulptorit Hektor Dule. Flisni më gjatë për këtë autor.

c) Citoni disa teknika të skulpturës në periudha të ndryshme, flisni më gjatë për një të njërën prej tyre.

Teza nr. 11.

a) Ku gjenden respektivisht shpellat “Lascaux” dhe “Altamira”? Bëj një përshkrim të pikturës së shpellave, figurave shenjave dhe destinacionin e tyre në shoqërinë primitive.

b) Cili është autori i skulpturës monumentale “Heronjtë e vigut”? Shpjegoni kontekstin kohor kur është realizuar kjo vepër.

c) Flisni për instalacionin, karakteristika dhe ndryshimi i tij nga skulptura. Përshkruani secilën prej tyre.

Teza nr. 12.

a) Flisni për monumentin “Davidi” i Mikelanxhelos. Prej nga është marrë tema e kësaj vepre dhe çfarë trajton ajo? Përmend disa vepra të rëndësishme të këtij autori.

b) Cito disa vepra të skulptorit Thoma Thomai. Përshkruani një të njërën prej tyre

c) Çfarë është një shtatore? Ku ndryshon ajo nga format e tjera të skulpturës?

Teza nr. 13.

a) Kush është autori i pikturës murale “Darka e fundit”? Ku ndodhet ajo? Prej nga është marrë tema e kësaj vepre dhe çfare trajton ajo? Përmend disa vepra të rëndësishme të këtij autori.

b) Cilët janë autorët e Monumentit të Pavarsisë në Vlorë? Në ç’kushte historike u ngrit kjo vepër?

c) Kush ishte Janaq Paço? Flisni për jetën dhe krijimtartinë e këtij skulptori shqiptar. Citoni disa vepra nga kya autor.

Teza nr. 14.

a) Kush ishte skulptori Auguste Rodin? Flisni dhe komentoni një vepër të tij.

b) Kur u shfaq metoda e “Realizmit Socialist” në Shqipëri dhe cili ishte tipari themelor i tij? Cito një veper tipike të Realizmit socialist shqiptar.

c) Thoni emrat e 5 skulptorëve bashkohor shqiptar dhe disa nga ekspozitat e tyre personale. Flisni më gjatë për njërin prej tyre.

Teza nr. 15.

a) Kush ishte skulptori Henri Moore? Flisni dhe komentoni një vepër të tij?

b) Kush janë autorët e skulpturës monumentale “Nënë Shqipëri” që ndodhet tek varrezat “Dëshmorët e Kombit” në Tiranë?

c) Flisni për skulptorin Perikli Çuli. Citoni disa vepra të tyre dhe përshkruajini ato.

Bibliografi

- Ernst H. Gombrich, *Historia e Artit*, (1996).
- Ermir Hoxha, *Historia e Artit Shqiptar 1858- 2000*, (2019)
- Rozela Dhimgjini, *Momente të Historisë së Artit nga Rilindja deri në shek. XX*, (2016).
- **Internet**: List of art movements.

